



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 37/5 prot.

Tiranë, më 29.1.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 724, datë 13.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Arben Agovi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 15.1.2024, është njoftuar vendimi nr. 724, datë 13.12.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Agovi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 724, datë 13.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Agovi, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, dhe referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin, z. Agovi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale.

3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Arben Agovi”, ka referuar:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2 Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimin e deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, ish-DSIK, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar (klasifikuar “Sekret”) me nr.*** prot., datë **.11.2017, ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit Arben Agovi është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës¹.

3.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

4. Përfundimet e Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** Trupi gjykues, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4.2 ***Për kontrollin e figurës.*** Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Arben Agovi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë **.7.2023, ju kërkua Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), përditësimi dhe deklasifikimi i Raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit. Sa më sipër është konstatuar përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

4.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Në përfundim, Komisioni vlerësoi se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv. Rastet dhe gjetjet e konstatuara lidhur me denoncimet, Komisioni nuk i konsideron të një problematike thelbësore, të cilat do të çonin në penalizimin e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në përfundim të këtij vlerësimi, subjekti i rivlerësimit konsiderohet “i aftë” dhe ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

5. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni, pasi ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arben Agovi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.*

II. Shkaqet e ankimit

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 724/2023, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, që vijnë në kundërshtim me vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, të vendosura në themel të mbrojtjes dhe forcimit të besimit të publikut, me ligjin nr. 96/2016, dhe përbëjnë shkak për vlerësimin tërësor të procedurave sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

11. Ashtu sikurse Kolegji ka interpretuar në jurisprudencën e tij², Komisioneri Publik vlerëson se, me qëllimin për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm të kriterit të aftësive profesionale, duhen të administrohen të gjitha burimet e vlerësimit dhe të vlerësohen të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në nenet 71, 72, 74, 75, 76 të ligjit nr. 96/2016. Gjithashtu, Kolegji ka konsideruar me rëndësi që, për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku.

12. Gjetjet në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në raport me burimet e vlerësimit të administruara, gjenden në denoncimet e paraqitura nga publiku, të cilat përmbajnë fakte apo rrethana, që përbëjnë provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

13. Në Komision rezulton se janë protokolluar rreth 15 denoncime, për të cilat, bazuar në rezultatet e hetimit, i janë kërkuar subjektit të rivlerësimit, shpjegime lidhur me të dhënat në to, dhe i ka kaluar barra e provës për 7 (shtatë) prej tyre. Në referencë të arsyetimit të vendimit, konstatojmë se Komisioni, me gjithë problematikat e konstatuara në denoncimet e administruara, ka vlerësuar se rastet dhe gjetjet e konstatuara lidhur me denoncimet, nuk i konsideron të një problematike thelbësore, të cilat do të çonin në penalizimin e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Komisioneri Publik, në analizë të gjetjeve të vetë Komisionit mbi çështjet e mësipërme, vlerëson se problematikat e hasura në çështjet e analizuara, janë të tilla që afektojnë konkluzionin se subjekti arrin nivel minimal kualifikues sipas nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, dhe luajnë një rol të posaçëm në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit sipas nenit 4, pika 2 e këtij ligji.

15. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 724, datë 13.12.2023, të Komisionit, ushtrohet në vlerësim tërësor të procedurave³.

II.A Analiza e shkaqeve të ankimit

16. Hetimi i Komisionit lidhur me kriterin e aftësive profesionale është bazuar në administrimin e të gjitha burimeve të vlerësimit, ndër të tjera, dhe në vlerësimin e denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncuese.

17. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për sa trajtuar në vijim:

18. *Lidhur me gjetjet nga informacionet e denoncimeve nga publiku.* Në vijim të përfundimeve të arritura nga Komisioni në shqyrtim të shkaqeve të denoncimeve, nisur dhe nga fakti që jurisprudenca e Kolegjit ka theksuar rëndësinë që ka në procesin e rivlerësimit, vlerësimi i denoncimeve nga publiku dhe rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë,

² Referohuni vendimit orientues (JR) nr. 21/2019, të Kolegjit.

³ Referohuni vendimit (JR) nr.19/2021, prg. 27.6: [...] *Lidhur me pretendimin se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, aplikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka çeduar në të tria kriteret e, për rrjedhojë, qëndrimi në detyrë i tij do të cenonte besimin e publikut, është i pabazuar. Gjuha e ligjit nuk e lidh aplikimin e këtij konkluzioni në formë kumulative me secilin prej kriterëve. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut lidhet me vlerësimin tërësor sipas kuptimit të nenit 4, pika 2 e ligjit, që përcakton vendimmarrjen në një ose disa kritere apo vlerësimin tërësor të procedurave. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj [...].*

Komisioneri Publik çmon se, për të arritur në konkluzionin përfundimtar, nëse sjellja e subjektit në raport me detyrën është e pranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i atij sistemi, duhet t'i nënshtrohen juridiksionit rivlerësues dhe të dhënat e rezultuara nga këto denoncime, konkretisht:

19. Denoncim i shtetasit * ***(nr. *** dt. **7.2019).** Denoncuesi pretendon se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, mbi bazën e kallëzimit të tij, ka regjistruar procedimin penal nr.***, datë **.1.2016, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të K. Penal. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore të plota dhe të gjithanshme, që janë urdhëruar nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe se subjekti nuk duhej të kërkonte pushimin e çështjes.

19.1 Rrethanat e faktit. Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë, e cila, me shkresën nr.***/* prot., datë **.9.2023, ka vënë në dispozicion praktikën mbi vendimin **penal nr. *** të vitit 2016.**

19.2 Nga aktet rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Lezhë ka regjistruar procedimin penal nr.***, datë **.1.2016, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të K. Penal, në bazë të kallëzimit penal të shtetasit ***. ***, dërguar në të njëjtën kohë dhe pranë disa institucioneve të tjera, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, e cila e ka sjellë materialin kallëzues pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lezhë.

19.3 Në kallëzimin e tij, shtetasi ***. ***, shprehet se, nëna e tij, ***. ***, ka trashëguar një pasuri truall nga babai i tij, pasuri për të cilën ka disponuar ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të ish-Pronarëve Lezhë, për njohje dhe kthim, për të cilën është proceduar me regjistrimin e saj pranë ZVRPP Lezhë, sipas vërtetimit hipotekor të regjistruar nr. ***, datë **.12.1996, të përfaqësuesit të ZVRPP Lezhë.

19.4 Në lidhje me këtë pasuri, kallëzuesi shprehet se, nga ana e disa funksionarëve, i është dhënë një shtetasi tjetër, ***. ***, me AMTP-në e vitit 2003, datë **.2.2003, me nr.***/*, duke e pajisur shtetasin ***. ***, me sipërfaqe prej 3.638 m² truall. Sipas kallëzuesit, kjo sipërfaqe toke ka qenë e regjistruar më parë në emër të shtetasit ***. ***, (gjyshi i shtetasit ***. ***). Denoncuesi po ashtu pretendon, ndër të tjera, se kjo tokë e kaluar në mënyrë të paligjshme shtetasit ***. ***, gjoja është shitur në vlerën 500.000 lekë në vitin 2006, si dhe është lënë peng si kolateral nga blerësit pranë *** Bank, për të siguruar kredinë 36.000.000 lekë, sipas marrëveshjes për dhënie kredie të vitit 2008.

19.5 Rezulton se në lidhje me çështjen penale nr.***, viti 2016, regjistruar në bazë të kallëzimit penal të shtetasit ***. ***, nga ana e Prokurorit të çështjes, në atë kohë ***. ***, është vendosur pushimi i çështjes penale, në bazë të nenit 328, pika 1, germa “d” të K. Pr. Penale, vendim ky i datës **.4.2016.

19.6 Ndaj vendimit të pushimit është bërë ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, e cila, me vendimin e saj nr.***, datë **.11.2016, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të hetimeve dhe rifillimin e tyre sipas dhe orientimeve përkatëse, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin e saj nr. ***, datë **.11.2017.

19.7 Ndër të tjera, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, ka arsyetuar se: “Nga ana e Prokurorisë, pavarësisht se është vendosur regjistrimi i procedimit penal, nuk është kryer pothuajse asnjë

veprim hetimor në lidhje me kallëzimin e paraqitur nga ana e ankuesit. Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi, se ndjekja penale nuk duhet të fillojë për shkak të kalimit të 10 viteve nga kryerja e veprimeve prej personave të tretë. Kështu, nga kallëzuesi pretendohet se veprimet janë kryer nga viti 2003, por ka pasur veprime edhe në qershor 2006 (që është momenti i lëshimit të certifikatës së pronësisë), por edhe më pas janë kryer veprime mbi këtë pasuri. Në këto kushte duhet që të ishin verifikuar veprimet konkrete dhe koha e kryerjes së tyre dhe më pas të arrihej në konkluzionin nëse ndodhemi para parashkrimit apo jo”.

19.8 Pas dërgimit të vendimeve përkatëse gjyqësore mbi shfuqizimin e vendimit të pushimit të hetimeve, më datë **.4.2018, është proceduar për hedhjen e shortit për caktimin e prokurorit për ndjekjen e hetimeve dhe, më datë **.4.2018, nga subjekti i rivlerësimit është marrë vendimi për rifillimin e hetimeve, të çështjes penale nr. ***/2016, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të K. Penal. Me urdhrin e datës **.4.2018, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar *Oficerin e Policisë Gjyqësore, që ka qenë caktuar më parë për hetimin e kësaj çështje, për kryerjen e detyrave të lëna nga Gjykata me vendimin nr. ***/2016 si dhe të relatojë mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve deri më datë **.6.2018.*

19.9 Subjekti i rivlerësimit, me datë **.4.2019, ka paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. ***, datë **.1.2016, duke arsyetuar, ndër të tjera, *se përfundimisht nga hetimet e kryera në lidhje me çështjen penale konkrete rezulton të jemi para disa veprave penale për të cilat dhe është regjistruar procedimi penal. Pavarësisht se këta persona ...kanë kryer veprën penale të “Falsifikim i dokumenteve” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”, sipas neneve 186 dhe 248, të K. Penal, nuk mund të procedohet me ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasve, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale⁴.*

19.10 Gjykata e Shkallës së Parë, Lezhë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2019, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë mbi pushimin e çështjes penale nr. ***/2016, ndër të tjera, duke arsyetuar se: *“është e vërtetë që, siç edhe pretendon pala kallëzuese, se kemi një sërë veprimesh që në momentin që është depozituar kallëzimi penal i shtetasit ***. ***, nuk ishte parashkruar ndjekja penale e tyre, por afati i parashkrimit është plotësuar gjatë kohës që çështja ishte në hetim. Si rrjedhojë, edhe pse veprimet e kryera në lidhje me lëshimin e AMTP-së, në emër të shtetasit ***. ***, përbëjnë elemente të veprave penale të parashikuara nga neni 248 dhe 186 i K. Penal, Gjykata çmon se, me të drejtë, organi i akuzës ka arritur në përfundimin se çështja duhet të pushohet duke qenë se ndjekja penale është parashkruar pasi është plotësuar afati i parashkrimit të këtyre veprave penale, nga koha e kryerjes së tyre, deri në momentin eventual të njoftimit të akuzës”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë **.7.2019.*

19.11 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se:

(1) *Subjekti duket se nuk ka respektuar udhëzimet e gjykatave, që e kanë urdhëruar atë të hetojë në mënyrë të detajuar me një orientim të veçantë për përdorimin e dokumenteve të falsifikuara pas qershorit 2006;*

⁴ Kërkesa e subjektit për pushimin e çështjes penale nr. ***, datë **.1.2016, duket se është bërë pas analizimit të fakteve dhe provave të administruara në dosjen hetimore, si dhe kryerja e disa veprimeve të tjera hetimore dhe procedurale. Në përfundim është konkluduar se veprat penale për personat e akuzuar janë parashkruar (Neni 3 i K. P. – Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale).

(2) *Vendimi i Gjykatës së Apelit është dhënë në nëntor 2017. Prokuroria e ka hedhur në short çështjen në prill 2018. Subjekti duhet të shpjegojë se pse zgjati kaq shumë për regjistrimin e çështjes pas 5 muajsh nga vendimi i Gjykatës. Subjekti duhet të shpjegojë se kush i ka organizuar procedurat e shortit në caktimin e kësaj lënde;*

(3) *Subjekti duket se nuk ka hetuar lidhjen e të dyshuarit kryesor me të afërmit e tij, të cilëve i është shitur pasuria e regjistruar me dokument të falsifikuar, në vitin 2006;*

(4) *Duket se subjekti nuk ka hetuar dhe sqaruar çmimin joreal të shitjes prej 500.000 lekë, të një pasurie me vlerë vetëm pak muaj më vonë, në shumën 22.000.000 lekë. Dhe një vit më vonë, një tepricë prej 3.600.000 lekë;*

(5) *Duket se subjekti nuk ka hetuar nëse i dyshuari kryesor ka pasur përfitime nga veprimtaria e të afërmit, ndërkohë që dokumenti i falsifikuar i pronësisë është dorëzuar në banka apo aktivitete të tjera biznesi ndër vite;*

(6) *Duket se subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të verifikuar veprimtarinë e OPGJ-së, e cila supozohej (bazuar në urdhrin e subjektit të prillit 2018) të paraqiste rezultatet e hetimit brenda qershorit 2018. Vetëm në tetor 2018 (pothuajse 6 muaj pas), subjekti i rivlerësimit gjeti se OPGJ nuk po ndiqte udhëzimet e tij dhe ato të gjykatave, pasi OPGJ ishte e bindur se çështja duhej të pushohej përsëri në afatet kohore⁵. Për më tepër, urdhri i caktuar për OPGJ-në, për të hetuar, ishte shumë i përgjithshëm dhe pa përcaktuar asnjë hap hetimor, për të plotësuar kërkesat e gjykatave;*

(7) *Gati në një vit hetimi, subjekti i vlerësimit duket se nuk ka regjistruar asnjë emër të personit të cilit i atribuohet vepra penale, nuk ka dhënë shtyrje dhe ka motivuar vendime, çdo 3 muaj, siç kërkohet nga Kodi i Pr. Penale.*

19.12 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se:⁶ [...] Në lidhje me çështjen konkrete, nga unë, prokurori Arben Agovi, pas rifillimit të procedimit penal me dt.**.4.20018 (pas hedhjes në short manual datë **.04.2018), në rezultate të veprimeve hetimore, është konkluduar, me kërkesën e datës **.4.2019, me objekt: “pushimin e çështjes penale” ... **Gjykata vlerëson në vendimin e saj se ...Organi i akuzës, ashtu siç citohet dhe më sipër, ka verifikuar të gjitha veprimet konkrete dhe kohën e kryerjes së tyre, dhe, duke pasur parasysh kohën e kryerjes së tyre, ka arritur në konkluzionin se ndjekja penale është parashkruar, duke qenë se veprimi i fundit është i datës **.10.2006.**

- *Procedurat e shortit, sikurse dhe rezulton, janë organizuar nga ana e Zyrës së Regjistrimit nën monitorimin e Drejtuesit të Prokurorisë... **Ndërkohë, një ditë më pas dhe, konkretisht, më dt.**.4.2018, është marrë nga ana ime vendimi “Për rifillimin e hetimeve të çështjes penale të shfuqizuar nga Gjykata”.***

- *Sa i takon nënpikës lidhur me hetimin e lidhjeve të të dyshuarit kryesor me të afërmit e tij, të cilëve i është shitur pasuria, gjatë fazës së hetimeve, e theksoj, pas rifillimit të hetimeve, është proceduar jo vetëm me administrimin, duke cituar këtu sekuestrimin e praktikës në fjalë, pranë ish-ZVRPP Lezhë, ku ndodhet e gjithë praktika konkrete, dhe ku janë cituar dhe aktet konkrete, por është proceduar dhe me marrjen e deklarimeve në cilësinë e personit që tregon*

⁵ Referuar vendimit për zëvendësimin e Oficerit të Policisë Gjyqësore, datë **.10.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë, bazuar në kërkesën e vetë subjektit të rivlerësimit, administruar në dosje të Komisionit.

⁶ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.

rrethana të hetimit shtetasit ***. ***, sipas procesverbalit përkatës dt. **.12.2018, ku shtetasi në fjalë, shprehet se shtetasit ***. ***, dhe ***. ***, janë djemtë e dajës së tij.

- **Sa i takon nënpikës lidhur me mosverifikimin e çmimit të shitjes së pasurisë, fillimisht në një vlerë prej 500.000 lekësh dhe, disa muaj më vonë, në shumën 22.000.000 lekë, dhe një vit më vonë, një tepricë prej 3.600.000 lekësh, sa i takon këtij momenti, të parashtruar nga ana e Juaj, duhet të përmend faktin e rezultuar ..., ku palët të kenë rënë dakord për çmimin e shitjes në vlerën 500.000 lekë. Pra, është një marrëveshje mes palëve dhe ku nga hetimet e kryera, të paktën deklarimet e shtetasit *** ***, nuk deklarohet apo kallëzohet që veprimi të jetë kryer jo në kushte marrëveshjeje reciproke...**

- **Sa i takon nënpikës lidhur me përfitimet që mund të ketë pasur i dyshuari kryesor, dhe këtu kuptohet shtetasi ***. ***, nga veprimtaria e të afërmeve, nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar që shtetasi ***. ***, të ketë pasur përfitime të tjera, veç sa çmimit të shitjes së sipërfaqes së tokës në fjalë...**

- **Sa i takon nënpikës lidhur me verifikimin e veprimtarisë së Oficerit të Policisë Gjyqësore të ngarkuar me kryerjen e hetimeve... Në këtë urdhër nuk janë specifikuar detyrat konkrete që duhet të kryejë Oficeri i Policisë Gjyqësore, pasi ato ishin përcaktuar më parë dhe të detajuara nga ana e Gjykatës së Shkallës së parë, Lezhë, në vendimin e saj nr.***, dt.**.11.2016, dhe madje në këtë Urdhër kryerje veprimesh hetimore, në pikën 1 të tij, është urdhëruar që të kryejë të gjitha veprimet hetimore të lëna detyrë për t'u kryer të përcaktuara nga ana e Gjykatës... Ndërkohë që në takime të mëtejshme formale në mënyrë verbale, ndër të tjera, dhe në lidhje me çështjen konkrete ku i është kërkuar se çfarë veprimesh ka kryer, me çështjen konkrete, më është relatuar se ai i qëndronte vlerësimit se çështja duhej pushuar për shkakun që ishte vendosur nga prokurori i mëparshëm ***. ***.**

- **Sa i takon nënpikës lidhur me mosregjistrimin e emrave të personave që u atribuohet vepra penale, nuk janë dhënë shtyrje, zgjatje afatesh dhe motivuar vendime, çdo tre muaj, bëj me dije, sikurse dhe ka rezultuar se, nisur nga detyrat konkrete dhe rezultatja e tyre është arritur në konkluzionin se personat konkretë të kenë kryer veprime të kundërligjshme, në kuptim të realizimit të figurave të veprave penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”. Por, nisur nga koha e kryerjes së këtyre veprimeve, nuk mund të procedohej me regjistrimin e emrave të këtyre shtetasve si persona që u atribuoheshin veprat penale konkrete, pikërisht nisur nga “Instituti i Parashkimit”[...].**

19.13 Komisioni, në përfundim, ka arsyetuar se, për këtë rast, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse. Nuk konstatohen problematika thelbësore për subjektin e rivlerësimit në këtë çështje nga momenti i fillimit të hetimit nga ana e tij. Për këtë çështje dhe për raste të tjera është evidentuar se vërtet Gjykata ka kthyer për hetime të mëtejshme çështjen, por në fund ka vendosur pushimin e çështjes sipas kërkesës së Prokurorisë. Gjykata ka konstatuar se vepra penale është parashkruar dhe, nga ana tjetër, është investuar dhe ka kërkuar që të kryhen veprime të tjera hetimore nga Prokuroria.

19.14 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm me arsyetimin e Komisionit, dhe nuk vlerëson se subjekti i rivlerësimit dha shpjegime bindëse apo provoi të kundërtën e barrës së provës për sa në vijim:

(1) Prokuroria është një organ, i cili realizon ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjykim, çka do të thotë, që ajo heton çdo lloj kallëzimi të shtetasve apo organeve të ndryshme

lidhur me vepra të caktuara penale të parashikuara si të tilla në K. Penal. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, Prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari. Përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t'iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues dhe parandalues.

(2) Aftësia për kryerjen e veprimeve hetimore brenda një afati ligjor dhe të arsyeshëm lejon Prokurorinë, që në përputhje me kërkesat e ligjit procedural dhe material penal, të mund të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me vazhdimin e hetimeve, dërgimin e tyre në gjyq apo pushimin e hetimeve, si dhe evidentimin dhe cilësimin e saktë të veprës penale, personave të përfshirë, apo shkelje të tjera eventuale të mundshme.

(3) Rezulton e provuar se subjekti nuk ka respektuar udhëzimet e gjykatave, që e kanë urdhëruar atë të hetojë në mënyrë të detajuar *me një orientim të veçantë për përdorimin e dokumenteve të falsifikuara pas qershorit 2006*, në kushtet kur rezulton se këto dokumente janë përdorur në kontrata shitblerje apo/dhe pranë institucioneve bankare, më së paku në vitin 2008, duke sjellë pasoja dhe përfitime për palët e tjera të përfshira.

(4) Pretendimet e subjektit mbi takimet formale dhe bisedat verbale me Oficerin e Policisë Gjyqësore, mbi kontrollin e ecurisë hetimore, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk justifikohen nga aktet në dosje. Subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse mbi mungesën e konkretizimit dhe saktësisht të veprimeve hetimore në urdhrin e lëshuar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mungesën e mbikëqyrjes së veprimeve të Oficerit të Policisë Gjyqësore.

(5) Po ashtu dhe argumentet e subjektit lidhur me mungesën e hetimit mbi çmimin e shitblerjes së tokës dhe vlerës së saj në kontratën e hipotekimit, nuk qëndrojnë, pasi nga aktet duket se kishte të dhëna të mjaftueshme për transaksionin dhe vlerën e dyshimtë të tij, të cilat duhet të shërbenin si indicie për verifikime të mëtejshme. Thellimi i veprimeve hetimore, dhe kualifikimi i saktë i veprës penale dhe personave përgjegjës për kryerjen e saj është kompetencë e prokurorit dhe nuk duhet të neglizhohet si rezultat i kalimit të afateve të parashkrimit.

19.15 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, sipas kërkesave ligjore dhe vendimit të Gjykatës, si dhe ka treguar mungesë të analizës dhe argumentimit logjik. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer një hetim të plotë, si dhe nuk ka mbledhur të gjitha provat e kërkuara, për qartësimin e rrethanave të kallëzimit, në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

20. Denoncim i shtetasit * ** (nr. ***, dt.**.9.2019).** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, më datë **.6.2019, ka marrë vendim për pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit ***. ***. Denoncuesi parashtrohet se është pronar i 8.800 m² tokë, ndodhur në fshatin *** Lezhë, Nj. Adm. ***, Lezhë, pronë e trashëguar dhe e marrë me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, me AMTP me nr. ***, viti 1993. Ai pretendon se një pjesë e kësaj prone, në mënyrë abuzive, i është pushtuar nga një banor kufitar ***. ***, i cili ka qenë banor i fshatit *** Lezhë, para gushtit 1991 me (4 frymë) dhe rezulton i pajisur me tokë (gjithsej 17090 m²).

20.1 Shtetasi ***. ***. pretendon se banori kufitar ***. ***. ka falsifikuar dokumentin AMTP, ku në vend të 15.000 m², ai, me anë të dokumentit të falsifikuar, rezulton me 17.000 m² tokë të përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991, "Për Tokën". Denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurori për pushtim të paligjshëm të tokës, përvetësim të paligjshëm të pasurisë

publike dhe falsifikimit të dokumenteve zyrtare nga shtetasi ***. ***, dhe pretendon se ka mbi 16 vjet që nuk gjen drejtësi dhe arsyeja se përse i drejtohet përfaqësuesve të reformës në drejtësi është absurditeti i vendimit të datës **.6.2019, të prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, z. Arben Agovi, i cili i ka kërkuar Gjykatës: Pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuara nga nenet 185/1 dhe 248 të K. Penal.⁷

20.2 **Rrethanat e faktit.** Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, e cila, me shkresën nr.***/* prot., datë **.9.2023, ka vënë në dispozicion praktikën mbi procedimin penal nr. ***, të vitit 2018.

20.3 Nga aktet rezulton se, subjekti i rivlerësimit, më datë **.9.2019, ka dërguar në Gjykatë “Kërkesën për pushimin e hetimeve”, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/1 dhe 248 të K. Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66/1/c të K. Penal.

20.4 Subjekti i rivlerësimit, duke parashtruar dhe vendimet gjyqësore civile, në të cilat ishin trajtuar pretendimet e denoncuesit⁸, ka referuar se shtetasi ***. ***, ndërkohë kishte aplikuar për legalizim për një objekt me destinacion objekt shërbimi në Njësinë Administrative ***, dhe, pas verifikimit në terren dhe përputhjes me lejen e legalizimit, ishin rregulluar problematikat e konstatuara në Bllokun kadastral nr.***, dhe ky shtetas ishte pajisur me leje legalizimi për objektin “Godinë shërbimi 1 kat”. Sa më sipër, nuk ka elemente të veprës penale të “Pushtim të tokës”.

20.5 Ndërsa lidhur me veprën penale të shpërdorimit të detyrës, ka vazhduar arsyetimin subjekti i rivlerësimit, rezulton se Kryetari i Komisionit të ndarjes së tokës së fshatit që ka lëshuar AMTP-në, e ka konsumuar atë, por nuk provohet se nga kush është depozituar në ZVRPP Lezhë, AMTP-ja nr.***, pa datë në emër të shtetasit ***. ***,⁹ ndërkohë që përfitues rezulton të jetë po shtetasi ***. ***. Regjistrimi më i hershëm është bërë në vitin 2004. Sa më sipër, kjo çështje duhet pushuar, për shkak të parashkrimit të veprës penale.

20.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lezhë, me vendimin nr.***, datë **.7.2020, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë e kthimin e akteve për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K. Penal, lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për pushimin e pjesëshëm të hetimeve në lidhje me veprën penale, të parashikuar nga neni 200 i K. Penal ...etj.”. Gjykata ka çmuar se kërkesa e Prokurorisë nuk duhet pranuar, pasi nuk është rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, për rrjedhojë, duhet t’i kthehen aktet për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme. Në këtë kontekst, Prokuroria duhet të kryejë të gjitha veprimet hetimore për të provuar: a)

⁷ Denoncuesi citon dy vendime gjyqësore me të cilat i është dhënë pjesërisht e drejta, në lidhje me pushtimin e 2200 m² tokë nga shtetasi kufitar ***. ***. (vendimi i pazbatuar dhe i ankimuar nga pushtuesi i tokës), dhe në lidhje me pushtimin e 3325,9 m² tokë (vendim i ankimuar). Për këtë denoncim është kërkuar praktika pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë.

⁸ Nga aktet rezulton se denoncuesi pretendimet e tij ia ka nënshtruar dhe juridiksionit gjyqësor civil. Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendimin gjyqësor civil nr. **, datë **.1.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së këtij shtetasi, si dhe detyrimin e të paditurit ***. ***, t’i kthejë shtetasit ***. ***, sipërfaqen prej 2.200 m² tokë bujqësore. Në vendim është arsyetuar se i padituri ***. ***, e posedon pjesërisht pasurinë 134/7 me sip.8.800 m², pra posedon vetëm 2.200 m² në keqbesim. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.***, datë **.3.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm dhe kthimin e çështjes për rigjykim me një trup tjetër gjykuese, pasi është formuar keqndërgjyqësia. Çështja në fjalë, nisur nga vendimet gjyqësore më sipër, i është nënshtruar sërish shqyrtimit gjyqësor civil pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, me gjyqtar tjetër, i cili ka disponuar me vendimin nr.***, datë **.2.2019, në të cilin ka vendosur: “Detyrimin e palës së paditur ***. ***, për lirimin dorëzimin e sendit, sipërfaqen prej 3.325.9 m² që posedon i padituri brenda pasurisë ***/*, me shënimet përkatëse sipas aktit të ekspertimit teknik”.

⁹ Referuar akteve të administruara në dosje, denoncuesi pretendon se e bija e shtetasit ***. ***, është punonjëse e ALUIZNI-t Lezhë.

ekzistencën e faktit penal dhe b) autorin e veprës penale. Pasi të ketë sqaruar këto elemente të hetimit dhe të ketë konkluduar, duhet të analizojë nëse ka shkaqe ndëshkueshmërie apo jo.

20.7 Duke qenë se vepra e falsifikimit kryhet vetëm me dashje, ka vazhduar Gjykata arsyetimin e saj, problemi ligjor që shtrohet për diskutim është nëse shtetasi ***, ***, ka qenë në dijeni të faktit që dokumenti ka qenë i falsifikuar dhe, nëse me dashje, është përdorur ky dokument në favor të pretendimeve të tij, pasi siç del nga gjykimi, ky shtetas ka qenë i vetmi që ka pas interes për paraqitjen dhe përdorimin e këtij dokumenti. Nga ana e Prokurorisë, edhe pse është vërtetuar një fakt i tillë në kundërshtim me ligjin, *as që është hetuar në lidhje me qëllimin e kësaj vepre penale.*

20.8 Ndaj këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit, më datë **.10.2020, ka ushtruar ankim pranë Gjykatës së Apelit, duke arsyetuar, ndër të tjera, se *kryerja e hetimeve të mëtejshme, si për anën objektive apo dhe qëllimin që pretendon Gjykata e Shkallës së Parë, për sa kohë nuk mund të konkludohet me dërgim në gjyq apo dënim të personave fajtorë, do ishte e panevojshme, pasi ndjekja penale për ta është parashkruar.*

20.9 Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë **.11.2020, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. **, dt. **.7.2020, me arsyetimin se shkaqet e ngritura në ankim nga shtetasi ***, ***, çojnë në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Shkallës Parë (nr.**, dt. **.7.2020), është i bazuar plotësisht në ligj dhe në prova, dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Gjykata e Apelit i ka konsideruar shkaqet e ankimit të ngritura nga organi i Prokurorisë si të pabazuara, *në kushtet kur veprimet hetimore nuk janë të plota në drejtim të ekzistencës së faktit penal të pretenduar, në lidhje me nenin 186/1 të K. Penal. Detyrat për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, për sa kohë ato janë me qëllim që të provojnë dyshimin e ekzistencës së veprës penale të pretenduar, konsiderohen si veprime që kanë rëndësi lidhur me përgjegjësinë penale apo ekzistencën e veprave penale konkrete.*

20.10 Subjekti i rivlerësimit, më datë **.6.2021, ka ridërguar në Gjykatë kërkesën për pushim hetimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lezhë, me vendimin nr. ***, dt. **.2.2022, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe ka vendosur pushimin e hetimeve për kryerjen e veprave penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuara nga nenet 186/1/2 e 248 të K. Penal, si dhe deklarimin e falsitetit të dokumentit AMTP me nr. ***, pa datë, lëshuar në emër të shtetasit ***, ***.

20.11 Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, dt. **.6.2022, ka prishur këtë vendim duke e kthyer për rigjykim përsëri pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë. Më pas, kjo e fundit me vendimin nr. **_***_***, datë **.11.2022, ka vendosur “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, duke pushuar hetimet për procedimin penal nr. ***, të vitit 2018, për veprat penale, të parashikuara nga nenet 186/1/2 dhe 248 të K. Penal”.

20.12 Në përfundim, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota dhe shteruese, duke mos evidentuar përgjegjësitë përkatëse të personave nën hetim dhe në interpretim të gabuar të nenit 186/1 të K. Penal, si dhe në kundërshtim me rrethanat e çështjes në shqyrtim.*

20.13 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, është shprehur se:¹⁰ *[...] Pa hyrë në detaje, pasi ato janë vërejtur nga ana e Juaj, me dt. **.09.2019, është vendosur pushimi i hetimeve ndaj shtetasit ***, ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i*

¹⁰ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.

*K. Penal, pasi pati rezultuar se gjatë fazës së hetimeve u administrua shkresa nr. ***/* prot. dt. **.03.2019, të ALUIZNI-t Lezhë, ku informoheshim se është përgatitur Blloku kadastral nr. *** në z. k. ***, i cili, bazuar në shkresën e dërguar nga ZVRPP Lezhë, ka kaluar të gjithë procedurën administrative, duke përfunduar përmirësimin e tij.*

- *Në lidhje me kërkesën për pushimin e çështjes penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të K. Penal, nga hetimet e kryera pati rezultuar se ndodhemi para veprës penale të “Shpërdorim të detyrës”, sipas nenit 248 të K. Penal, nga personi në cilësinë e Kryetar i Komisionit të Ndarjes së Tokës së Fshatit që ka lëshuar AMTP-në nr. ***, pa datë ...si dhe nga këqyrja e të gjithave praktikave të regjistrimit të pasurive në emrin e ***. ***. Nuk provohej se nga kush është depozituar në ZVRPP Lezhë, AMTP-së nr. ***, pa datë, në emrin e këtij shtetasi, ndërkohë që përfitues të rezultojë të jetë pikërisht shtetasi ***. ***. Regjistrimi më i hershëm është bërë në vitin 2004.*

- *Ndaj përfundimisht, konkludohej se duhej proceduar me pushimin e hetimeve për veprat penale të “Falsifikim të dokumenteve” dhe të “Shpërdorim të detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të K. Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për këto dy vepra penale për arsyet e lartpërmendura, duke i lidhur me kohën e kryerjes së veprave penale [...].*

20.14 Komisioni, për këtë çështje ka arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lezhë ka vendosur rrëzimin e ankimit të shtetasi ***. ***, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit mbi pushimin e pjeshëm të hetimeve ndaj shtetasi ***. ***, në lidhje me veprën penale sipas nenit 200 të Kodit Penal dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë, duke kthyer aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2018, ku Gjykata shprehet në lidhje me nenin 248 të Kodit Penal. Në përfundim është vendosur me vendimin e Gjykatës datë **.11.2022, pranimi i kërkesës, pushimi i hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Nuk janë konstatuar problematika për subjektin e rivlerësimit për këtë çështje penale të ndjekur nga ana e tij.

20.15 Komisioneri Publik, në përmbledhje të sa më sipër, vëren se në procedimin penal të analizuar, subjekti sërish ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke pasjellë përcjelljen e çështjes në gjykim për pushimin e saj pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme, zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes dhe rolit, dhe përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në të.

20.16 Kjo situatë faktike, që lidhet me pushimin e çështjeve, pa kryer hetime të plota, me objekt kallëzime mbi vepra penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve, vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit për akuzat e personave të përfshirë në procedimin penal, funksionarë të shtetit, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. ***/2018, nuk arritën të ishin bindëse.

21. Denoncim i shtetasi * *** (nr. ***, dt. **.11.2020).** Denoncuesi pretendon se Prokuroria nuk është përpjekur të bëjë hetim të thelluar për të zbuluar dhe dokumentuar ekzistencën e një grupi të strukturuar kriminal, i cili, në marrëveshje midis tyre, kanë falsifikuar dokumente zyrtare, shpërdoruar detyrën dhe tjetërsuar pronat. Në kallëzimin penal, ky shtetas, ndër të tjera, ka shpjeguar në lidhje me tjetërsimin në kundërshtim me ligjin të parcelave

shtetërore “ranishte”, përgjatë bregut të detit, në zonën e plazhit të fshatit *** ***, tek zona e quajtur “*** **”, në Njësinë administrative ***, Bashkia Lezhë.

21.1 Denoncuesi pretendon se, nga viti 2005, ai dhe trashëgimtarët e tjerë të pronave në Bashkinë Lezhë, kanë kaluar një kalvar të gjatë në përpjekje për njohjen dhe kthimin e tokave të trashëguara. Mbi bazën e konstatimeve të tyre kanë bërë një kallëzim penal në Prokurorinë Lezhë, më datë **.8.2019, të cilin Prokuroria e ka vendosur ta regjistrojë më datë **.9.2019. Me hetimin e çështjes është ngarkuar subjekti i rivlerësimit.

21.2 **Rrethanat e faktit.** Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, e cila, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.9.2023, ka bërë me dije se procedimi penal nr. ***/2019, më datë **.2.2021, është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Bashkëlidhur kësaj shkrese, Prokuroria ka përcjellë vendimin e prokurorit për kalimin e akteve, datë **.2.2021.

21.3 Nga aktet rezultojnë se procedimi penal nr. ***, të vitit 2019, është regjistruar mbi bazën e materialit hetimor të referuar nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, si dhe kallëzimit penal të shtetasit ***, ***, ***. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se, gjatë periudhës 2016, Bashkia Lezhë ka dërguar për regjistrim në ZVRPP, sot ASHK, Lezhë dokumentacionin për pajisjen me tokë të shtetasve ***, ***, ***, dhe ***, ***, ***. Praktikantët e dokumentacionit të dërguara nga Bashkia Lezhë, përmbajnë aktin e marrjes së tokës në pronësi, vërtetimet e kufizimeve, konfirmimet e pasurive, planet e rievimit, si dhe certifikatën familjare të datës **.8.1991.

21.4 ZVRPP, Lezhë, pas administrimit të dokumentacionit, ka konstatuar se sipërfaqet e pasurive nuk janë tokë bujqësore, por ranishte. Për këtë arsye, nga ZVRPP Lezhë është kërkuar konfirmim për dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë, duke iu drejtuar me shkresa përkatëse Bashkisë Lezhë dhe Këshillit të Qarkut Lezhë. Në vijim i kanë kthyer përgjigje ZVRPP-së, ku, ndër të tjera, është konfirmuar se pasuritë janë të llojit “arë”. Pas marrjes së përgjigjeve, ZVRPP ka proceduar me regjistrimin e këtyre pasurive, ku, sipas dispozitave të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, nuk duhej të procedonte me regjistrimin e këtyre dy pasurive.

21.5 Sipas akteve të ekspertimit tekniko-grafik me nr.***, datë **.2.2020, dokumentacioni i pajisjes me tokë në emër të shtetasve ***, ***, ***, dhe ***, ***, ***, është i falsifikuar dhe nga ekspertimi topografik ka rezultuar se sipërfaqet e përfituara me dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë janë ranishte, dhe jo tokë bujqësore (arë).

21.6 Sa më sipër, prokurori ka shënuar në kolonën përkatëse të regjistrimit të procedimeve penale për procedimin penal nr. ***/2019, emrat e disa funksionarëve të lartë¹¹ dhe nëpunësve të administratës vendore dhe asaj qendrore në nivel vendor, si dhe shtetasit përfitues të dy pasurive, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186/2, dhe 186/3 të K. Penal.

21.7 Referuar nenit 75/a, pika “c” të K. Pr. Penale, më datë **.2.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur¹² kalimin e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2019, për shkak të

¹¹ Njëri prej tyre, ***, ***, ish-kryetar i Bashkisë Lezhë.

¹² Neni 75/a, pika c e ç, të K. Pr. Penale përcaktojnë se: Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon: ...c. Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Anëtarit të Këshillit të Ministrave, Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

moskompetencës lëndore, duke i kaluar aktet te Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë.

21.8 Komisioni, lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi konstatoi se:

(1) *Duket se subjekti ka kryer disa hapa hetimi, të cilat shkojnë përtej afatit kohor standard të kërkuar për hetim (3 muaj), pa iu referuar ndonjë akti të motivuar shtyrjeje të hetimit;*

(2) *Në aktin e transferimit të kësaj çështjeje, rezulton që subjekti të ketë regjistruar emrat e personave të cilëve u atribuohen veprat penale, pas disa hapave hetimorë. Në të njëjtin akt, këta persona cilësohen edhe nga subjekti si konsumues/kryer, të krimeve në fjalë;*

(3) *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë se kur i ka regjistruar emrat e të dyshuarve, si dhe të shpjegojë dhe të provojë, nëse gjatë hetimit, janë nxjerrë akte me motive shtyrjeje, duke qenë se çështja është regjistruar në **vitin 2019**, dhe ka kaluar në **SPAK në shkurt 2021**.*

21.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, është shprehur se:¹³ *[...] Nisur nga nënpikat e parashtruara nga ana e juaj, bëj me dije se duke qenë se nuk është proceduar që në krye të herës me regjistrimin e emrit/ve të personit/ve që t'u atribuohen veprat penale, nuk mund të procedohej me zgjatje të afatit të hetimeve, duke ia nënshtruar çështjen, kryerjes dhe rezultatit të veprimeve hetimore, të cilat janë të konsiderueshme, derisa është arritur në konkluzionin mbi ekzistencën e figurave të veprave penale konkrete dhe lëshimin e urdhrat për regjistrimin e emrave të personave që u atribuohen veprat penale, **urdhër ky i datës **.2.2021**, dhe duke qenë se bëhej fjalë për ish-kryetarin e Bashkisë është proceduar me shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas vendimit të datës ****2.2021**, e cila e ka pranuar çështjen penale dhe, në dijeninë time, është proceduar me paraqitjen e kërkesës për dërgimin për gjyq të çështjes konkrete pranë Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar [...].*

21.10 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë hetim penal nga ana e subjektit. Në bazë të hetimit të tij, dhe regjistrimit më pas të personave ndaj të cilëve ka filluar hetimi, është bërë i mundur dërgimi dhe ndjekja e kësaj çështjeje penale pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

21.11 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se pretendimet e denoncuesit gjejnë mbështetje në aktet në dosje. Akti i ekspertimit tekniko-grafik, mban datën ****2.2020**, nga ku ka rezultuar se dokumentacioni i pajisjes me tokë në emër të shtetasve *****. ***. ***.** dhe *****. ***. ***.** është i falsifikuar dhe, ndërkohë, dhe nga ekspertimi topografik ka rezultuar se sipërfaqet e përfituara me dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë janë ranishte dhe jo tokë bujqësore (arë). Ndërkohë, vendimi i transferimit mban datën ****9.2021**.

21.12 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, në drejtim të trajtimit të çështjeve penale që lidhen me falsifikimin e dokumenteve dhe shpërdorimin e detyrës, në tjetërsimin e pronave, duke pasur parasysh natyrën e problematikave të trajtuara, duhet të kishte

Kryetari të Bashkisë, Deputetit, Zëvendësministrit, Anëtarit të KLGJ-së dhe të KLP-së dhe drejtuesve të Institucioneve Qendrore ose të Pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj. ç. Akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

¹³ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.

treguar vëmendje maksimale dhe të shtuar, duke qenë proaktiv në përdorimin e të gjitha mjeteve ligjore, që do të lexohej nga publiku, që akuzat për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumenti trajtohen me seriozitet maksimal nga prokurorët.

21.13 Rastet e neglizhencës dhe zvarritjet e dukshme shfaqin sjellje që nuk ngjallin besim të sistemi i drejtësisë drejt përcaktimit në kohë të përgjegjësisë të personave të përfshirë, kur rezulton se në të gjitha këto raste subjekti i rivlerësimit ka vendosur të mos regjistrojë emrat e personave në regjistrat e veprës penale dhe të zgjasë hetimet përtej afateve të lejuara, rrethana që prekin indikatorët e përcaktuar nga neni 73/2/3 i ligjit nr. 84/2016.

22. Denoncim anonim¹⁴ (nr. *, dt. **.1.2022).** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar në kundërshtim me ligjin shtetasin ***, ***. (i cili nuk jeton më), në masën e dënimit, i cili ka qenë i akuzuar për dy vepra penale, atë të vjedhjes dhe prodhimit e të shitjes së narkotikëve. Pavarësisht se ka qenë i akuzuar për dy vepra penale, prokurori Arben Agovi ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e mbetur, duke kërkuar dënimin e tij me kusht dhe jo me burg, për shkak të rrezikshmërisë së lartë që ai paraqiste¹⁵. Bashkëlidhur denoncimit gjendet vendimi nr. ***, datë **. 18.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë.

22.1 Komisioni, në vijim të verifikimit të informacioneve në denoncim, i kërkoi¹⁶ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë, kopje të dosjes së procedimit penal nr. ***, *viti 2018*, e cila, në përgjigjen nr. ***/* prot., datë **.9.2023, ka sjellë kopjen e plotë të dosjes së këtij procedimi penal, si dhe kopje të “Diskutimit përfundimtar” të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të kësaj çështjeje ndaj të pandehurit ***, ***.

22.2 **Rrethanat e faktit.** Nga dokumentacioni vërehet se subjekti i rivlerësimit ka hetuar çështjen në ngarkim të të pandehurit ***, ***, i cili është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vjedhje” dhe atë të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në formën e mbajtjes, të parashikuara nga neni 134/1 e 283/1 të K. Penal, ndërkohë që është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë Lezhë mbi pushimin e hetimeve lidhur me veprën penale “Nxitja për përdorimin e drogës”, sipas nenit 286/1, të K. Penal. Ky procedim është regjistruar në bazë të materialit referues nga ana e shërbimeve të Policisë Gjyqësore, të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, ndaj të njëjtit person për veprat penale, sipas neneve 283/1 dhe 286 të K. Penal.

22.3 Shtetasja (e dëmtuara), ***, ***, ka bërë kallëzim penal para Policisë Gjyqësore ndaj shtetasit ***, ***, të dy me banim në Lezhë, duke e akuzuar atë për vjedhjen e aparatit celular, shumës prej 50 euro, si dhe deklarimit të saj në lidhje me detyrimin e konsumimit të cigareve me lëndë narkotike¹⁷. Referuar deklarimeve të personave të dëmtuar dhe atyre që kanë dijeni, ka rezultuar, ndër të tjera, se nëna e të dëmtuarës ***, ***, ka deklaruar përpara Policisë Gjyqësore se ***, ***, ka vepruar negativisht ndaj të bijës duke i thyer telefonin, syzet, duke e rrahur, si dhe duke e shtyrë të pijë hashash.

¹⁴ Anonim, referon si *** ***.

¹⁵ Denoncuesi vazhdon denoncimin e tij duke sqaruar se shtetasi ***, ***, brenda kohës së dënimit me kusht, ka vrarë shtetasin ***, ***. (i ndjeri, ish-agjent policie). Gjithashtu, përveç kësaj, shtetasi ***, ***, arriti që, brenda kushtit të dhënë, të bëjë edhe një tjetër vepër tjetër penale, për të cilën u arrestua dhe më pas doli përsëri dhe vrau shtetasin ***, ***.

¹⁶ Shih shkresën me lëndë: *Kërkesë për informacion dhe dokumentacion*, me nr. *** prot., datë **.9.2023.

¹⁷ Janë kryer veprimet hetimore të nevojshme, nga ku ka rezultuar se, nga kontrolli i banesës së të pandehurit, është gjetur lëndë *cannabis sativa*; nga këqyrja e shtetases ***, ***, ka rezultuar se ajo ka dëmtime trupore, për shkak të rrahjes dhe dhunës së ushtruar nga i pandehuri me mjete të forta mprehëse, si dhe ka rezultuar prania e lëndëve narkotike në organizmin e saj (nga kryerja e ekspertimit toksikologjik).

22.4 Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinim fajtor të pandehurit ***. ***, për kryerjen e veprave penale “Vjedhje” dhe atë të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në formën e mbajtjes, të parashikuara nga nenet 134 e 283/1 të K. Penal, duke kërkuar dënimin e tij me 5 vite burgim e në aplikim të nenit 406 të K. Pr. Penale (Gjykimit të shkurtuar), dënimin me 3 vite e 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të K. Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e mbetur të pavaajtur të dënimit, duke e lënë me kusht për një afat 1 vit e 8 muaj.

22.5 Komisioni, sa më sipër, ka arritur në konkluzionin se: (i) referuar veprave penale për të cilat është ngritur dyshimi se shtetasi ***, ***, i ka kryer ato, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin për njërën prej tyre, atë të “Nxitjes për përdorimin e drogës”, sipas nenit 286/1 të K. Penal. Ndërkohë, duket se gjykata e ka pranuar këtë kërkesë të prokurorit; (ii) Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kërkuar në përfundim të hetimeve deklarinim fajtor të të pandehurit ***, ***, por ai ka kërkuar aplikimin e dënimit alternativ, siç është dënimi me kusht, duke e zëvendësuar dënimin përfundimtar me 3 vite e 4 muaj burgim me atë 1 vit e 8 muaj me kusht.

22.6 Sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se, në aspektin e vlerësimit të aftësive të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket aspektit procedural të hetimit të dosjes në ngarkim të shtetasit ***, ***, subjekti nuk mund të kërkonte pushimin e hetimit për veprën penale të parashikuar nga neni 286/1 i K. Penal, për sa kohë ka rezultuar e provuar se kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka arritur në konkluzionin që duket se subjekti nuk ka hetuar plotësisht dhe ndjekur penalisht të pandehurin ***, ***, për veprat penale të shtrëngimit me anë të kanosjes, dhunës dhe nxitjes për përdorimin e drogës të bërë ndaj shtetasit ***, ***, si dhe nuk ka kërkuar masën e dënimit në përputhje me ligjin penal.

22.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, është shprehur se:¹⁸ [...] *Nuk rezulton të provohet se shtetasi ***, ***, të ketë konsumuar veprën penale “Nxitja për përdorimin e drogës”, parashikuar nga neni 286/1 i Kodit Penal, pavarësisht se shtetasja ***, ***, ka shpjeguar se ka qenë shtetasi ***, ***, ai që ka ndikuar në vullnetin e saj pa pëlqimin e saj, për të përdorur lëndën narkotike të llojit cannabis (hashash). ...Kërkesa me objekt “Dërgimin për gjyq të çështjes penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 283/1 të Kodit Penal” dhe “Pushimin e çështjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 286/1 i Kodit Penal”, është paraqitur para Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, ku gjyqtari i seancës paraprake e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë, ku e pranishme në seancën paraprake ka qenë edhe shtetasja ***, ***, dhe, konkretisht, për rastin konkret...*

*Ndërkohë, nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar të jemi gjendur para veprës penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, sipas nenit 109/a të Kodit Penal, pasi ka rezultuar se situata e ndodhur mes shtetasve ***, ***, dhe ***, ***, ...Sikurse është arsyetuar në kërkesën përkatëse, sa i takon veprës penale “Vjedhje”, sipas nenit 134/1 të Kodit Penal dhe konkluduar edhe në vendimin gjyqësor, shtetasi ***, ***, është akuzuar dhe dënuar për veprën penale sipas nenit 134/1 të Kodit Penal, pasi ka përvetësuar një send të shtetasit ***, ***, në rastin konkret, aparatën e saj celular, pa dëshirën e vullnetin e saj, duke e privuar nga e drejta e pronësisë dhe e posedimit të lirshëm mbi sendin e saj [...].*

¹⁸ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.

22.8 Komisioni, në vijim, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota lidhur me hapat proceduralë të ndjekur, hetimin e kryer, si dhe vlerësimin e bërë në tërësi për këtë çështje. Komisioni, ndër të tjera, shprehet se mund të ishte vlerësuar me mirë nga ana e subjektit procedimi penal për sa i takon veprës penale “Nxitja për përdorimin e drogës”. Dënimi alternativ është dhënë nga Gjykata për shtetasin ***, ***, për shkak se nga të dhënat nuk rezultonte se gjendeshin para një personi me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në atë kohë.

22.9 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni në vendim, vlerëson se gjetjet e rezultateve të hetimit, dhe mbi këtë rast, duhen t’i nënshtrohen juridiksionit rivlerësues të Kolegjtit, më së paku, lidhur me analizën dhe arsyetimin logjik të prokurorit mbi aplikimin e nenit 59 të K. Pr. Penale dhe në referimin e masës së dënimit alternativ, në drejtim të indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, dhe të vlerësohen në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

23. Denoncim i shtetasës * ***(nr. ***, dt.**.9.2021).** Denoncuesja ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit *** ***, për veprën penale të “Mashttrimit”, të kryer në bashkëpunim me shtetasen ***. ***, dhe për “shpërdorim detyre”, ndaj punonjësve të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë, Lezhë. Denoncuesja pretendon se i është drejtuar Prokurorisë për informacion në fazën ku ndodhen hetimet, por nuk ka marrë përgjigje.

23.1 Sipas denoncueses, ajo ka pasur martesë me shtetasin ***. ***, dhe me vendimin nr. ***, datë **.10.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, kishin zgjidhur martesën. Me kontratë nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.11.2009, shtetasi ***. ***. ka blerë një apartament banimi te shtetasi ***. ***. Me kontratën nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.6.2011, shtetasi ***. ***. e ka shitur apartamentin në fjalë shtetasës ***. ***, që është motra e tij, fakt për të cilin denoncuesja shprehet që nuk i ka dhënë pëlqimin për këtë veprim.

23.2 **Rrethanat e faktit.** Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, e cila, me shkresën nr.***/* prot., datë **.9.2023, ka theksuar se kjo çështje penale është nën hetim dhe, me shkresën nr.***/* prot., datë **.10.2023, ka vënë në dispozicion praktikën mbi procedimin penal nr. ***, të vitit 2020.

23.3 Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit, më datë **.3.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasja *** ***. Regjistrimi i procedimit është bërë nga subjekti i rivlerësimit, për veprën penale të “Mashttrimit”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, pa emër personi që i atribuohet vepra penale.

23.4 Më datë **.3.2020 është urdhëruar nga subjekti i rivlerësimit, kryerja e disa veprimeve hetimore nga OPGJ, deri më datë **.4.2020. Deri me këtë datë duket se janë kryer vetëm disa veprime hetimore (kryesisht shkresa për njoftim dëshmitarësh dhe deklarata nga personat që kanë dijeni për çështjen), kurse veprimet e tjera hetimore, sidomos komunikimet me institucionet shtetërore, duket se janë kryer përtej datës **.4.2020.

23.5 Për këtë çështje, në përfundim të hetimit, subjekti i rivlerësimit, më datë **.10.2020, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, me kërkesë për “Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.***, viti 2020”. Kërkesa është bërë nga prokurori pas relacionit të OPGJ-së, të datës **.10.2020, “Për mënyrën e përfundimit të procedimit penal nr.***, viti 2020”.

23.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lezhë, me vendimin nr. *** datë, **.12.2020¹⁹, ka vendosur: (i) Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë; (ii) Kthimin e akteve; (iii) Detyrimin e Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve që duhet të përfundojnë brenda afatit 3-mujor.

23.7 Në këtë vendim, Gjykata, midis të tjerash, ka arsyetuar se: [...] *Në rastin konkret prokurori duhet të hetojë nëse shtetasit *** *** dhe *** ***, me atë të veprimeve konkrete, gënjeshtres, shpërdorimit të besimit të shtetases së dëmtuar, *** ***, kanë cenuar pikërisht këto marrëdhënie. Në rastin konkret, prokurori duhet të hetojë dhe të dalë në një konkluzion të saktë: Pse pikërisht gjatë acarimit të marrëdhënieve u realizua dhe kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2011, lidhur ndërmjet *** ***, me cilësinë e shitësit dhe *** ***, me cilësinë e blerësit? [...].*

23.8 Pas këtij vendimi, në dosjen e sjellë nga Prokuroria nuk ka akte mbi ecurinë e mëtejshme të kësaj çështjeje dhe zbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata.

23.9 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi konstatoi se:

(i) Subjekti duhet të japë shpjegim lidhur me shkaqet dhe argumentet e paraqitura nga Gjykata Lezhë, për kthimin e kërkesës së tij për pushimin e hetimit;

(ii) Duket se subjekti ka regjistruar procedimin penal për kallëzimin për veprën penale të “Mashtrimit”, pa referuar emrin e personit konkret për të cilën ka filluar ndjekja penale;

(iii) Duket se subjekti nuk ka kryer veprimet hetimore dhe përfundimin e tyre brenda afatit të caktuar nga vetë ai;

(iv) Duket se subjekti nuk ka nxjerrë akte të tjera procedurale për vazhdimin e hetimit, duke përcaktuar dhe afate të tjera kohore;

(v) Duket se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim lidhur me marrjen e dëshmisë së personit të akuzuar për veprën penale të mashtrimit;

(vi) Duket se subjekti nuk ka regjistruar dhe nuk ka ndjekur hetime lidhur me veprën penale të shpërdorimit të detyrës ndaj punonjësve të ZVRPP Lezhë;

(vii) Subjekti duhet të japë shpjegime të hollësishme, lidhur me ecurinë e kësaj çështjeje, pas vendimit të Gjykatës Lezhë, për kthimin e kërkesës së tij.

23.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se:²⁰ [...] *Çështja ka nisur mbi bazë kallëzimi penal të shtetases ***.*** dhe ku gjatë fazës së verifikimeve janë ndërmarrë veprimet për kryerjen e verifikimeve të kallëzimit penal nr. ***, datë **.2.2020, ndërkohë që shtetasi ***,***. nuk rezultonte të ndodhej në Shqipëri dhe brenda afatit ligjor më **.3.2022, është proceduar me regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Mashtrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ku gjatë hetimeve do të konkludohej nëse ndodheshim para elementeve të figurës së veprës penale dhe, nëse po, para regjistrimit të emrit të personit që do t’i atribuohet kjo vepër penale, apo në rast të ekzistencës së veprave të tjera penale dhe personave konkretë.*

Sa i takon nënpikës lidhur me veprimet hetimore të kryera në afatin përkatës, është i vërtetë fakti se pas regjistrimit të procedimit penal është urdhëruar Policia Gjyqësore në Prokurori

¹⁹ Vendim i lënë në fuqi me vendimin nr. **, datë **.2.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

²⁰ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.

*për kryerjen e veprimeve përkatëse, duke lënë afatin përkatës datë **.4.2020, veprime të cilat rezultojnë të mos jenë kryer të gjitha në këtë afat të lënë Policisë Gjyqësore, ndërkohë që është urdhëruar në vazhdimësi verbalisht Policia Gjyqësore për kryerjen e detyrave të lëna apo edhe të tjera që do të dilnin, sikurse dhe ishte urdhëruar të vepronte.*

Sa i takon nënpikës lidhur me dukjen mbi moskryerjen e hetimeve lidhur me veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” ndaj punonjësve të ZVRPP-së Lezhë, bëj me dije se, që në momentet e para të kryerjes së verifikimeve të kallëzimit penal, pa u regjistruar çështja si procedim penal është kërkuar informacioni dhe dosja konkrete, pra praktika, ZVRPP Lezhë, dhe duke qenë se kjo praktikë nuk u soll në ato momente, fakt ky i pasqyruar edhe në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, është rikërkuar sipas urdhrin të dhënë nga ana e Policisë Gjyqësore, praktika përkatëse ZVRPP Lezhë, të cilët gjatë fazës së hetimeve e kanë dërguar praktikën [...].

23.11 Në përfundim, Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka vlerësuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lezhë e ka kthyer për hetim këtë çështje pranë Prokurorisë, pasi subjekti duhet të hetonte edhe veprimet mes shtetasve ***. ***, dhe ***. ***, ndaj shtetasës ***. ***. (***) . Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me hetimet e kryera, si dhe me mosfillimin e procedimit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, por nuk ka shpjeguar bindshëm pse nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore, para se çështjen ta dërgonte në Gjykatë për pushim. Detyrat e lëna ndaj Oficerit të Policisë Gjyqësore nuk verifikohen plotësisht, pasi, edhe sipas subjektit janë lënë verbalisht. Për këtë çështje është vazhduar më tej hetimi nga Prokuroria e Rrethit Lezhë, pasi subjekti është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

23.12 Komisioneri Publik, sa më sipër, vëren se në procedimin penal të analizuar, subjekti sërish ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë përcjelljen e çështjes në gjykim për pushimin e saj, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme, zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes, rolit dhe përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në të, si dhe kërkesave dhe pretendimeve të kallëzueses.

23.13 Kjo situatë faktike vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 96/2016. Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. ***/2020, ashtu siç ka vlerësuar edhe Komisioni, nuk arritën të ishin bindëse.

24. Denoncim i shtetasit * ***(nr. ***, dt. **.10.2021).** Denoncuesi pretendon për zvarritje të procesit mbi 2 vite, në procedimin penal nr. ***, datë **.7.2019, të regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

24.1 **Rrethanat e faktit.** Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, e cila, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.9.2023, ka theksuar se kjo çështje penale është nën hetim dhe me shkresën nr. ***/* prot., datë **.10.2023, ka vënë në dispozicion praktikën mbi procedimin penal nr. ***, të vitit 2019.

24.2 Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë **.7.2019, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi *** ***, duke caktuar detyra për Oficerin e Policisë Gjyqësore. Regjistrimi i procedimit është bërë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

24.3 Më datë **.7.2019 është nxjerrë urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore – procedurale, pas studimit të akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2019. Ky urdhër përcaktonte

kryerjen e disa veprimeve të mëtejshme hetimore procedurale, deri më datë **.11.2019 (për shkak dhe të sezonit të pushimeve).

24.4 Referuar akteve në dosje të Komisionit, rezulton se, me shkresën nr. *** prot. (***. ***.), datë **.4.2021, subjekti i rivlerësimit ka informuar denoncuesin, z. *** ***, se “*çështja penale është ende në fazën e hetimeve, nisur dhe nga korrespondenca me institucionet e tjera, e ndikuar kjo dhe nga pandemia Covid-19, duke përbërë ky, gjithashtu, një shkak të lidhur me ecurinë e hetimeve, pa dashur të kapemi pas kësaj situatë, sidoqoftë problematikave, në çdo aspekt*”.

24.5 Komisioni, nisur nga fakti i mungesës së dokumentacionit të plotë për këtë çështje nga ana e Prokurorisë si çështje ende në hetim, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, shpjegime të hollësishme lidhur me hapat hetimorë të ndjekur prej tij, hetimet e kryera, vonesat dhe zgjatjet e hetimeve për këtë çështje (kërkesa për zgjatje dhe miratimet përkatëse), *edhe pas kalimit të afatit 2-vjeçar nga regjistrimi i saj.*

24.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi²¹ se: *[...] Në dijeninë time, nga ana e Policisë Gjyqësore janë kryer veprime në lidhje me kërkimin e dokumentacionit përkatës, administrimin e dokumentacionit posedues, prej shtetasit *** ***, dokumentacion voluminoz, që kërkonte kohën përkatëse për verifikim, ndërkohë që kujtoj se nga takimet me Policinë Gjyqësore, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Lezhë, për këtë çështje kishte problematikë, vonesë, sa i takon posedimit të dokumentacionit arkivor dhe verifikimit të situatës së pretenduar nga kallëzuesi, për shkak të volumit dokumentar, si dhe periudhës kohore, për të cilën bëhej fjalë. Ndërkohë, në vazhdimësi, është urdhëruar Policia Gjyqësore për kryerjen e detyrave të tjera përkatëse, të lëna në Urdhër. Ndërkohë është njoftuar shtetasi *** ***, ku t’i jenë bërë me dije, sikurse është bërë parashtrimi Juaj, mbi gjendjen dhe ecurinë e hetimeve.*

Nuk rezulton të jetë proceduar me zgjatje afatesh hetimore, për sa kohë nuk është proceduar me regjistrim emri personi/ash që t’u atribuohet vepra penale, ndërkohë që deri në momentin që jam transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në bazë të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, çështja nuk ishte përfunduar [...].

24.7 Në përfundim, Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka vlerësuar se shpjegimet e paraqitura për këtë rast nga subjekti nuk janë bindëse dhe qëndrojnë gjetjet e Komisionit në rezultatet e hetimit. Subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit lidhur me vonesat dhe zgjatjet e hetimeve për këtë çështje, edhe pas kalimit të afatit 2-vjeçar nga regjistrimi i saj.

24.8 Komisioneri Publik vëren se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse dhe nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, në procedimin penal të analizuar. Subjekti ka treguar mungesë të aftësive për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe veprime të nevojshme, brenda afatit kohor të përcaktuar, referuar dhe indikatorëve të nenit 74, pika 4, të ligjit nr. 96/2016, duke pasqyruar vonesa dhe zvarritje të çështjes që do të lexohej nga publiku, si një sjellje që nuk ngjallte besim te sistemi i drejtësisë.

²¹ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.

25. Kërkesë e shtetasit * ***, e datës **.7.2020.** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer vonesa në hetim dhe veprime të kundërligjshme në procedimin penal nr. ***, të vitit 2019.

25.1 Rrethanat e faktit. Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, e cila, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.10.2023, i ka përcjellë kopje të procedimit penal nr. ***, të vitit 2019.

25.2 Nga aktet, rezulton se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Lezhë, është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë **.5.2019, në bazë të kallëzimit të depozituar pranë kësaj Prokurorie nga shtetasi *** ***, në të cilin shprehet për regjistrimin në mënyrë të kundërligjshme nga ana e ZVRPP Lezhë, të një pasurie, në emër të shtetasve ***, *** dhe *** ***. Kallëzimi penal është bërë nga shtetasi *** ***, ndaj ZVRPP-së Lezhë, Bashkisë Lezhë, shtetasve ***, *** dhe *** ***, për veprat penale të parashikuara nga neni 186, 248, 84/320, 199/a1/a2 të Kodit Penal. Sipas kallëzuesit, këta të akuzuar kanë kryer veprime, si dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin, falsifikime dhe tjetërsim prone.

25.3 Në vijim, më datë **.6.2019, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë **.6.2019, për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Ky regjistrim i procedimit penal është bërë pa emër personi të regjistruar që t’i atribuohet vepra penale.

25.4 Më datë **.6.2019, nga subjekti i rivlerësimit është nxjerrë urdhri për kryerjen e disa veprimeve hetimore procedurale nga OPGJ, të cilat duheshin kryer deri më datë **.7.2019. Më datë **.6.2019, është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (nga kallëzuesi *** ***). Më datë **.6.2019, është mbajtur procesverbal për këqyrje dhe marrje të provave materiale. Gjatë kësaj periudhe kohore (**.6.2019- **.7.2019), janë kryer disa veprime hetimore dhe korrespondenca me institucione të ndryshme, hetime të cilat kanë vazhduar gjatë vitit 2019.

25.5 Më datë **.4.2020, subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2019 (dërguar Gjykatës me shkresën nr. ***, datë **.4.2020). Për kërkesën mbi pushimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar dhe kallëzuesin *** ***, më datë **.4.2020. Në kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, subjekti ka renditur faktet dhe hetimin e kryer, duke pasqyruar dhe argumentet për pushimin e hetimeve të procedimit penal. Kjo kërkesë është mbështetur në nenin 328/1, germa “b”, si dhe nenin 329 të K. Pr. Penale.

25.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lezhë, me vendimin nr. ***-***-***-**-***, të datës **.10.2020, ka vendosur: (i) Kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2019; (ii) Kryerjen e hetimeve për procedurën e ndjekur nga ZVRPP Lezhë, në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme dhe kryerjen e një akti të ri të ekspertimit teknik; (iii) Të kryen veprime të tjera hetimore brenda afatit 4 muaj.

25.7 Në këtë vendim, Gjykata, midis të tjerash, ka arsyetuar se: [...] Gjykata vlerëson se hetimet nuk janë kryer të plota në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e punonjësve të ish-ZVRPP Lezhë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme dhe verifikimit të paraqitjes ose jo të dokumenteve të falsifikuara, në kontekstin e elementeve të figurave të veprave penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe “Shpërdorimit të detyrës”,

parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Gjykata çmon se është e nevojshme kryerja e këtyre veprimeve hetimore:

Hetimin lidhur me procedurën e ndjekur nga ish-ZVRPP Lezhë në Regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, në të gjitha aspektet dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe akteve nënligjore në fuqi ...

Kryerjen e aktit të ri të ekspertimit teknik për sqarimin e rrethanave lidhur me ekzistencën ose jo të mbivendosjes së pronës së paluajtshme të regjistruar me pronat kufitare, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga të gjithë kufitarët në ish-ZVRPP Lezhë.

Hetimin në drejtim të falsitetit të dokumentit deklarativ të pronarit kufitar, të pretenduar nga kallëzuesi [...].

25.8 Më datë **.2.2021, nga drejtuesi i Prokurorisë Lezhë, është vendosur bashkimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2019, me aktet e kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2020, të cilin Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë e kishte regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K. Penal, mbi bazën e materialit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Nisur nga fakti se kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2020, që i përket shtetasit *** ***, ka të bëjë më të njëjtin fakt që përmban procedimi penal nr. ***/2019, është vendosur bashkimi i tyre.

25.9 Me hetimin e këtij procedimi është ngarkuar subjekti i rivlerësimit. Subjekti ka kryer disa veprime hetimore, më pas çështja është ndjekur nga Prokurori ***. ***, siç duket për shkak të transferimit të subjektit të rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

25.10 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi konstatoi se:

(i) Subjekti duhet të japë shpjegim lidhur me shkaqet dhe argumentet e paraqitura nga Gjykata Lezhë, për kthimin e kërkesës së tij për pushimin e hetimit;

(ii) Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota dhe shteruese për këtë çështje;

(iii) Duket se subjekti nuk ka respektuar vendimin e Gjykatës Lezhë (vendim i datës **.10.2020) për mbylljen e afatit të hetimit për këtë çështje brenda 4 muajve.

25.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar²² se: [...] Ndërkohë, Gjykata ka kërkuar hetimin pikërisht mbi faktin e hetuar nga ana e Prokurorisë, lidhur me çështjen konkrete, duke parashtruar verifikimin e disa pikave të tjera (të aspektit teknik-administrativ), po të VKM-së përkatëse.

Gjithashtu, nga ana e Gjykatës është vendosur kryerja e riekspertimit sipas orientimit përkatës, nisur pikërisht nga kërkesa e përfaqësuesit të kallëzuesit në seancë gjyqësore, në një kohë që gjatë hetimeve, pavarësisht relacionit të Oficerit të Policisë Gjyqësore, mbi përfundimin e hetimeve, nga ana ime si prokuror, u procedua pas analizimit të hetimeve përkatëse me këqyrjen e vendit, për të cilin bënte fjalë kallëzuesi dhe më tej me kryerjen e ekspertimit teknik-topografik. Rezulton se nga ana e Gjykatës, nuk është konstatuar i pavlefshëm akti i ekspertimit teknik-topografik, por nisur nga parashtrimet në Gjykatë, nga kjo e fundit është vendosur kryerja e riekspertimit përkatës.

²² Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit.

*Ndërkohë, sikurse është parashtruar dhe nga ana e Juaj, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, është vendosur bashkimi i procedimeve penale nr. ***, viti 2019, dhe nr. ***, viti 2020, në një procedim penal të vetëm, sipas vendimit përkatës të dt.**.02.2021. Pavarësisht se nga ana ime si prokuror është urdhëruar Policia Gjyqësore për kryerjen e detyrave të lëna nga ana e Gjykatës, pas analizave të kryera në lidhje me çështjen konkrete, me Policinë Gjyqësore, është proceduar nga unë si prokuror me marrjen e vendimit për administrimin e dokumentacionit përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, duke ngarkuar Policinë Gjyqësore në Prokurori dhe dërguar ky vendim agjencisë në fjalë, për përgatitjen e materialit përkatës, voluminoz ky, për disa pasuri, dhe i administruar pas një muaji nga ana e Policisë Gjyqësore pas përgatitjes së praktikave referente nga ana e Agjencisë. Administrimi i këtij dokumentacioni ishte i nevojshëm për kryerjen e veprimeve konkrete sipas detyrave të lëna nga ana e Gjykatës [...].*

25.12 Në përfundim, Komisioni, lidhur me këtë çështje, ndër të tjera, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota dhe ka dërguar në Gjykatë çështjen për pushim hetimi për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Ky vendim i Gjykatës nuk është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili duket se ka qenë dakord me vendimmarrjen e Gjykatës. Gjithashtu, subjekti nuk ka dhënë argumente dhe shpjegime bindëse pse nuk janë realizuar detyrat e caktuara nga Gjykata brenda 4 muajsh, si dhe pse nuk është kërkuar në Gjykatë zgjatja e hetimeve, nëse kishim të bënim me hetime të mëtejshme edhe pas këtij afati.

25.13 Komisioneri Publik, në përmbledhje të sa më sipër, vëren se, dhe në procedimin penal të analizuar, subjekti sërish ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë përcjelljen e çështjes në gjykim për pushimin e saj, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme, zbardhjen e plotë të mekanizmit të ngjarjes, rolit dhe përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në të.

25.14 Kjo situatë faktike vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit për akuzat e personave të përfshirë në procedimin penal, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. ***/2019, ashtu siç ka vlerësuar edhe Komisioni, nuk arritën të ishin bindëse.

26. Në përfundim të shkaqeve të ankimit të trajtuar më sipër, në zbatim dhe të jurisprudencës së Kolegjit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe etikës së subjektit të rivlerësimit, vlerësojmë se të metat e konstatuara në shqyrtimin e dosjeve të trajtuara gjatë procesit, evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë të subjekteve të rivlerësimit dhe duhet të vlerësohen negativisht.

26.1 Gjetjet në vlerësimin e kriterit profesional reflektojnë mangësi profesionale, të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit; si moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenet 73, pikat 2 dhe 3, dhe 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe si të tilla duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave të çështjes së subjektit të rivlerësimit, në

këndvështrim të perceptimit të publikut për mënyrën se si funksionon drejtësia, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

II. B. Lidhur me gjetjet në vlerësimin e kriterit të pasurisë

27. Komisioni, në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, nga analiza financiare ka konkluduar pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimi, në shumën - **765.210 lekë**, për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës 1993 – 2016, pamjaftueshmëri, të cilën, bazuar në parimin e proporcionalitetit nuk e ka konsideruar problematike për të penalizuar subjektin e rivlerësimit. Referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ka arsyetuar Komisioni, kjo mungesë burimesh financiare nuk mund të konsiderohet si deklaram i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27.1 Komisioneri Publik vlerëson se pamjaftueshmëria e konstatuar në mbulimin me burime të ligjshme të shtimit të pasurive dhe likuiditeteve të konkluduara nga Komisioni, edhe pse nuk është e mjaftueshme për të aplikuar parashikimet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, është e tillë që duhet çmuar nga Kolegji në vlerësim tërësor, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, referuar parashikimeve të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit.

II.C. Çështje të tjera

28. Denoncim anonim (nr. *, dt.**.1.2022)²³.** Sipas denoncuesit anonim, subjekti i rivlerësimit është i korruptuar, pasi çdo vërtetim në Prokurorinë Lezhë e ka lëshuar kundrejt korrupsionit, ashtu siç ka mbyllur dhe shumë dosje. Për këtë, denoncuesi jep dhe *link*, dhe tekstin e publikuar nga një emision televiziv²⁴.

28.1 Në përmbajtje të tekstit përmendet se prokurori Agovi ka përfituar në mënyrë korruptive shumën prej 500 euro. Komisioni, në rezultatet e hetimit, ka arsyetuar se çështjet e pretenduara janë në kuadrin e hetimit penal dhe nuk ka indicie për të vlerësuar ndonjë çështje të ndjekur nga subjekti. Në këtë aspekt, Komisioni vendosi mos hetimin e mëtejshëm administrativ për këtë denoncim.

29. Komisioneri Publik, duke i konsideruar të mjaftueshme shkaqet e ankimit të sipërtrajtuara, për arritjen e një vlerësimi përfundimtar mbi procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se rrethanat e mësipërme duheshin marrë në konsideratë nga Komisioni, duke i kërkuar shpjegime subjektit, dhe vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera, në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

III. Kërkimi i ankimit

30. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.

31. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në

²³ Referon si “**** **”.

²⁴ <https://top-channel.tv/2019/11/04/skandali-ne-fiks-fare-me-20-euro-nen-dore-kalon-piken-kufitare-drejt-vendeve-te-be-se/>

procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

32. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

33. Bazuar në nenin Ç, D, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016;

34. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 724, datë 13.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Agovi.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO